



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2010

SESIONI I

(I DETYRUAR)

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI B

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I**Petro Marko****Nata e Ustikës**

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	A	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	D	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë

Pyetja 7 3 pikë**Model përgjigjeje**

a) Gjendja emocionale e Andreas është ajo e një te riu të sapodashuruar, që ka shqetësimin e dashurisë së parë.

b) Fjalitë e përdorura janë pyetëse dhe thirrmore (mjafton që nxënësi të përmendë edhe vetëm njërën).

Shpjegimi: Andrea pushtohet nga emocionet. Ai është i befásuar nga ritakimi dhe mundohet të zbulojë domethënien e bisedës me Sonjën si dhe pengjet e brendshme të njeriut të dashuruar.

1 pikë Nëse tregon gjendjen emocionale të Andreas.

1 pikë Nëse tregon llojin e fjalive (ose pyetëse ose thirrmore).

1 pikë Nëse shpjegon këtë mënyrë përdorimi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, shpreh mendime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 8 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Përmes duarve përçohet ndjesia e takimit, e lidhjes, e mbështetjes dhe bashkimit njerëzor.
- Vetë duart janë një mënyrë komunikimi pa fjalë, por në një kontakt fizik gjithësesi mëson shumë për njëri-tjetrin.
- Prekja e duarve i transmeton ndjenjat po aq bukur sa dhe fjalët. Madje në mungesë të tyre janë duart ato që përcjellin ndjenjën më të shtrenjtë njerëzore.
- Gjuha e dashurisë shpesh nuk ka nevojë për fjalë.

E veçanta:

Vetë autori thotë se janë *thellësisht njerëzore*. Dhe kur ato janë të tilla, e tillë duhet të jetë edhe Sonja, lidhja e tyre, po kaq e ngrohtë dhe njerëzore.

Brenda tyre ai ndien jetën (*pulson zemra*).

1 pikë Nëse shpjegon pse vëmendja e Andreas përqendrohet pikërisht te duart.

1 pikë Nëse tregon të veçantën e tyre.

0 pikë Nëse përgjigja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, shpreh mendime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 9 3 pikë

Model përgjigjeje

Fakti autobiografik

Petro Marko është arrestuar dhe burgosur nga fashistët në burgun e Tiranës dhe në Ustikë.

Fjalitë njëkryegjymtyrëshe:

Emërore: Andrea! Soonja! Sonja?

Foljore: Po pse nuk i fola më gjatë? Si duhej ta nisja bisedën?

1 pikë Nëse shkruan një fakt autobiografik.

1 pikë Nëse shkruan një fjali një kryegjymtyrëshe foljore.

1 pikë Nëse shkruan një fjali një kryegjymtyrëshe emërore.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 2 pikë

Model përgjigjeje

Funksioni artistik: Kjo pranëvënie zbulon kontrastin midis realitetit ku jeton Andrea (burgut të zi ku jeta venit) dhe natyrës plot jetë dhe ndriçim (agimi, kaltra – deti dhe qielli)

Theksohet se sa e rëndë është drama e njerëzve që vuanin në atë ishull mungesën e lirisë.

1 pikë Nëse zbulon kontrastin.

1 pikë Nëse tregon se ç' theksohet përmes kësaj zgjedhjeje.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Shënim:

Pranëvënia mund të trajtohet edhe si paralelizëm figurativ, ndërtuar mbi kontraste.

Pyetja 11 2 pikë

Model përgjigjeje

Ato janë vargje të shkruara mbi portën e *Ferrit* dhe janë paralajmëruese për ata që do të hynë në atë portë, për gjithçka që i pret atje brenda.

Nënteksti është i qartë: brenda Ferrit, që në këtë rast është burgu i Ustikës, kuvlia e hekurt e vdekjes, nuk ka më asnjë shpresë. Vuajtja dhe dhimbja janë të përjetshme.

Vargu i Ferrit zbulon ideologjinë antinjerëzore të fashizmit.

Kjo ideologji, në të kundërt të propagandës së saj, mishëronte vdekjen, shfarosjen. Siç e thotë dhe vargu, ajo shuan shpresat dhe ëndrrat e njerëzve për lirinë dhe jetën.

1 pikë Nëse shpjegon pse autori i referohet pikërisht vargjeve të Dantes.

1 pikë Nëse shpjegon nëntekstin që ato mbartin.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, shpreh mendime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 12 3 pikë

Model përgjigjeje

- Figura e doktorit është një figurë kyç, që i shërben autorit të mishërojë idenë e tij humane. Doktorit përshkruhet si një njeri plot ndjenja dhe humanizëm. Pikërisht dashuria për njeriun dhe luftën e tij për liri e shtyn atë të betohet se do ta mbrojë Andrian.
- Autori e ka diferencuar atë nga kampi i fashistëve për të vënë në dukje shpresën e mbijetesës së këtij humanizmi.
- Ai nuk do të përfshijë të gjithë popullin italian nën uniformën e fashizmit, pasi kjo ideologji nuk përfaqësonte gjithë Italinë dhe kulturën e saj, por ishte një ideologji e një grupi të caktuar politik, që përgjaku së pari vetë popullin italian.

1 pikë Nëse shpjegon se pse doktori i betohet Andrian se do ta shpëtojë.

1 pikë Nëse shpjegon se pse autori e ka diferencuar doktorin nga italianët e tjerë.

1 pikë Nëse shpjegon se çfarë ka mishëruar autori përmes figurës së doktorit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, shpreh mendime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 13 **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku argumenton pse bota i takon ditës dhe jo natës;
- përqendrohet në idenë madhore që autori përcjell përmes saj në vepër, humanizmin që e përshkon;
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga fragmenti ose vepra;
- përdor detaje mbështetëse;
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë****1 pikë** **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen
 - zhvillimin
 - përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE **2 pikë**
(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.

PJESA II**Euripidi****Medea**

Pyetja 14	A	1 pikë
Pyetja 15	D	1 pikë
Pyetja 16	C	1 pikë
Pyetja 17	B	1 pikë
Pyetja 18	D	1 pikë
Pyetja 19	C	1 pikë
Pyetja 20	C	1 pikë

Pyetja 21 (a) 3 pikë**Model përgjigjeje**

a) Po, Medea është një grua dinake.

Detajimi i planit të hakmarrjes, planifikimi i tij, dëshmojnë se ajo është një grua dinake. E ka në karakterin e saj të planifikojë dhe të realizojë shumë gjëra me dredhi.

Ilustrimi: po pse kam ndërmend të vras me dredhi/ bijën e monarkut.

1 pikë	Nëse përcakton Medean si një grua dinake.
1 pikë	Nëse shpjegon pse ajo është e tillë.
1 pikë	Nëse jep ilustrimin e duhur.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 (b) 2 pikë**Model përgjigjeje**

b) Medea e përmend atdheun, babanë dhe familjen, sepse ndihet e braktisur, pa atdhe, pa shtëpinë e saj atërore.

Ajo ndihet e penduar që braktisi vendin e saj dhe tradhtoi njerëzit e saj.

1 pikë	Nëse tregon arsyen pse Medea përmend atdheun, babanë dhe familjen.
1 pikë	Nëse tregon si ndihet ajo.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 **2 pikë****Model përgjigjeje**

Medea shfaq disa gjendje shpirtërore: vendosmëri, dëshpërim, trishtim, mërzi, urrejtje, zemërim, inat, e palëkundur, pendim, zhgënjim.

2 pikë Nëse gjen dy gjendje të ndryshme shpirtërore.

OSE

1 pikë Nëse gjen vetëm një gjendje shpirtërore.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 **3 pikë****Model përgjigjeje**

Roli i korit nuk është ai i një vëzhguesi, por i një vlerësuesi, gjykuesi, komentuesi të situatës. Ai ndërhyr, këshillon dhe paralajmëron. Është vetë zëri i autorit, i ideve dhe qëndrimeve të tij.

Arsyeja 1: Medea nuk duhet ta kryejë aktin e tmerrshëm pasi është nëna dhe nuk është në të mirën e saj të lëndojë fëmijët, gjakun e saj.

Arsyeja 2: është kundra të gjitha ligjeve: të shkruara dhe të pashkruara qofshin.

OSE

Do të pranohet edhe ilustrimi me vargje:
*për të mirën tënde dhe për hir të ligjit,
të them: mos i bëj.*

OSE

Po dhe ti do bëhesh grua më e mjerë.

1 pikë Nëse shpjegon rolin e korit në tragjedi.

2 pikë Nëse identifikon dy arsye që kori parashtron para Medeas.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 **2 pikë****Model përgjigjeje**

Po. Medea është e justifikuar. Ajo i vret djemtë si hakmarrje ndaj Jasonit. Ajo nuk gjen asnjë rrugëdalje tjetër, pasi e gjen veten në kurth: e tradhtuar nga i shoqi dhe pa asnjë mundësi për t'u rikthyer në atdheun e saj (pasi ka vrarë vëllanë dhe tradhtuar besimin e popullit të saj).

Në luftën midis gruas dhe nënës fiton gruaja.

Ilustrime:

Po, se kështu vetëm burri im do digjet.

Jo. Asgjë nuk e justifikon vrasjen e fëmijëve. Nëna që të jep jetën nuk mundet të ta marrë atë për asnjë lloj arsye. I gjithë veprimi i saj duket i palogjikshëm, kur mendon se e bën vetëm për inat dhe urrejtje ndaj Jasonit.

*do t'ia kthej përmbys
shtëpinë Jasonit*

*Askush mos më marrë për grua të keqe,
për një të sëmurë ose për të urtë (justifikim i palogjikshëm)*

OSE

Medea i vret fëmijët për të ndëshkuar Jasonin: “*Ti heqë atij buzëqeshjen*”. Por ky është një akt që çdo nënë do ta shikonte të pamundur. Të bësh diçka të tillë vetëm për ta bërë bashkëshortin të vuajë është tepër ekstreme dhe jo reale.

1 pikë Nëse argumenton se a është Medea e justifikuar në veprën që do të kryejë.

1 pikë Nëse e mbështet argumentimin me ilustrime nga fragmenti ose vepra.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, shpreh mendime që nuk i përmban modelin e përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 25 **2 pikë**

1 pikë Raporti është sinonimik.

1 pikë Theksohet vendosmëria, palëkundshmëria në vendimin e marrë tashmë, përmbyllja e planit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.